

Formular për SYLLABUS të Lëndës: EKONOMIA E INTERNETIT

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik: Departamenti Ekonomiks
Titulli i lëndës:	EKONOMIA E INTERNETIT
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore në Drejtimin: Ekonomiks
Viti i studimeve:	Viti i 2-të
Numri i orëve në javë:	2 orë ligjërata + 1 orë ushtrime
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	
	<p><i>Lënda: Ekonomia e Internetit është lëndë e re në Fakultetin Ekonomik dhe është lëndë zgjedhore në drejtimin: Ekonomiks. Ekonomia e Internetit nenkupton ndryshimet rrenjesore te cilat kane ndodhur ne ekonomine bashkekohore, te cilat jane rezultat i ndikimit te teknologjise se internetit dhe te cilat kane sjellur deri te globalizimi i cili nga dita ne dite po mer permasa gjithnje e me te medha. Në orët e ligjëratave studentëve ju ofrohen njohuri teorike nga fusha e aplikimit të teknologjisë së Internetit në ekonomi . Studentët do të njohtohen me principet bazë të funksionimit të ekonomisë së internetit në rrethat kur përdorimi i teknologjisë së rrjetave kompjuterike sidomos Internetit është bërë domosdoshmëri dhe imperative kohore. Ekonomia e Internetit dallon në mënyrë eseciale nga ekonomia tradicionale. Ekonomia e Internetit ka ofruar nje menyre te re te zhvillimit te afarizmit- afarizmin elektronik. Pjesëmarrës kryesorë në ekonominë e interneit janë: qeveria, bizneset dhe individët. Nën ndikim të Internetit ka ardhur deri te nje realitet i ri virtual si rezulatat i se cilit ndermarrjet industriale jane transformuar ne ndermarrje digjitale dhe janë në presion të përherëshëm të zhvillojnë afarizmin e tyre në kushtet e një konkurrence të ashpër. Gjithashtu, është synim që studentët të njihen me kkarakteristikat e ekonomise se Internetit, trendet e reja ne ekonomin e Internetit, konceptin e sistemit nervor digjital, konvergjencen e tre teknologjive ne teknologjin e Internetit, Modelin e biznesit B-Web etj. Ne orët e ushtrimeve do të plotësohen njohuritë nga orët e ligjëratave dhe do të punohet me studentë rreth</i></p>

	<p><i>konkretizimit të temave të zhvilluara në ligjerata. Ushtrimet do të pasurohen edhe me punë në grup të studentëve në projektet e tyre dhe hulumtime në Internet rreth temave të caktuara me interes nga kjo fushë.</i></p>		
Qëllimet e lëndës:	<p><i>Qëllimi i lëndës: Ekonomia e Internetit është që studentët të fitojnë njohuri nga fusha e Ekonomisë së Internetit dhe ndryshimet rrënjësore të cilat kanë ndodhur në ekonominë bashkëkohore si rezultat i përdorimit të Internetit si rrjetë e rrjetave kompjuterike dhe infrastrukture për zhvillimin e afarizmit. Poashtu, lënda ka për qëllim të vejë në dukje rritjen e rolit dhe të rëndësisë së informatave, diturisë dhe kapitalit intelektual si resurse jo materjale në kushtet e ekonomisë së re. Do të synojmë që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të nevojshme për të përdorur Internetin për qëllime të zhvillimit të afarizmit në kushtet e ekonomisë së re dhe për të përdorur njohuritë e tyre në situata të ndryshme.</i></p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Studentët do të kuptojnë se si mund të përdoret teknologjia informatike dhe teknologjia e Internetit për qëllime afariste, do të mund të bëjnë krahasime midis ekonomisë së Internetit dhe ekonomisë tradicionale, të përcaktojnë resurset ekonomike në ekonominë e re dhe në ekonominë industriale, të bëjnë dallimin ndërmjet pozitës së ndërmarrjeve dhe të konsumatorit në këtë ekonomi në ekonominë e vjetër etj. Qëllim po ashtu do të jetë nxitja e hulumtimeve individuale dhe grupore, me qëllim që studentët ta përdorin Internetin si një veçël në funksion të rritjes së aftësive të tyre akademike.</i></p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2 orë (5 grupe nga 1 orë)	2 orë / 1 javë	10 orë/ 1 javë
Ushtrime teorike/laboratorike	2 orë (10 grupe nga 1 orë)	2 orë / 1 javë	20 orë / 1 javë
Punë praktike	Hulumtime në Internet		

	dhe punë grupore në projekte.		
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	Konsultime 2 orë	2 orë / 1 javë	
Ushtrime në teren	-		
Kollokfiume,seminare	Punë në projekte grupore		
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Mënyra e mbajtjes së mësimit është në pajtim me kërkesat bashkëkohore të mësimdhënjes dhe me sistemin e kredive ECTS dhe deklaratën e Bolonjës. Praktikohet përdirimi i pajisjes bashkëkohore të teknologjisë informatike: kompjuterik dhe projektori. Në kuadër të terminit të paraparë të ligjëratave, përkundër numrit të madhë të studentëve, bëhet orhanizimi i tyre në grupe më të vogla, mvareshit nga numri i studentëve që marin pjesë në ligjëratat. Në ligjëratën e parë studentët informohen lidhur me menyrën e punës dhe në bashkëpunim me ta përcaktohet mënyra e mbajtjes së mesimit.</i></p>		
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Sipas statusit te UP-së</i></p>		
Literatura :	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mihane Berisha-Namani: Ekonomia e Internetit, Prishtinë, 2013. 2. Mihane Berisha-Namani: Biznesi elektronik, Prishtinë, 2011. 3. Patrick Mckeown: Information Technology and the Networked Economy, Zurich, 2009 4. Lane, N.: “Advancing the Digital Economy into 21st Century”. Information Systems Frontiers. 1:3, 1999. 		
Literatura bazë:	<p><i>Literatura e domosdoshme:</i></p>		

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mihane Berisha-Namani: Ekonomia e Internetit, Prishtinë, 2013. 2. Mihane Berisha-Namani: Biznesi elektronik, Prishtinë, 2010 3. Dr. Mihane Berisha-Namani: Informatika e biznesit-Ligjërata, Prishtinë, 2004
Literatura shtesë:	<p><i>Lliteratura e rekomanduar/shtesë:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 5. Mckeown, P.: <i>"Information Technology and the Networked Economy"</i>, Zurich, 2009 6. Park, J. Yark, L. & Lee, Ch: <i>"Future Information Technology"</i> Greece, 2011. 7. Lane, N.: <i>"Advancing the Digital Economy into 21st Century"</i>. Information Systems Frontiers. 1:3, 1999. 8. Pianic, Z.: <i>"Bogatstvo Interneta"</i>, Zagreb, 2000. 11. James, O.B.: <i>"Computers in Business Management"</i>, London, 2000.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet:
Java e parë:	Ligjërata informuese dhe organizimi i punës lidhur me mbajtjen e mesimit. Studentët organizohen në grupe dhe në nëngrupe dhe nga ata kërkohet të japin mendimin e tyre lidhur me praktikën më të mirë rreth mënyrës së mbajtjes së mesimit. Meren vendime rreth kohëzgjatjes së pauzave ndërmjet orëve dhe rregullat e punës gjatë orëve të mesimit.
Java e dytë:	Shpërndahet informata e shtypur dhe programi i lëndës: Ekonomia e Internetit. Studentet informohen rreth syllabusit të lëndës, literaturës dhe ofrohet një hyrje në lëndë, qëllimin dhe objektivat e saj.
Java e tretë:	Shoqëria informatike dhe ekonomia e Internetit. Definimi i shoqërisë Informatike dhe karakteristikat e saj.
Java e katërt:	Ekonomia e Internetit-Koncepti dhe definimi. Rrjetat kompjuterike si infrastrukturë në ekonominë e Internetit. Internati, Intraneti dhe Ekstraneti.
Java e pestë:	Dallimi ndërmjet Ekonomisë së Internetit dhe ekonomisë së vjetër. Resurset ekonomike në Ekonominë e Internetit.
Java e gjashtë:	Kollokviumi 1.

Java e shtatë:	Informatat dhe dituria si resurse ekonomike jo materjale në Ekominë e Internetit. Rëndësia e kapitalit intelektual në Ekominë e Internetit.
Java e tetë:	Pozita e ndërmarrjeve në Ekominë e Internetit. Dallimi i ndërmarrjeve digjitale nga ndërmarrjet industrial.
Java e nëntë:	Pozita e konsumatorit në Ekominë e Internetit. Konvergjenca e teknologjisë kompjuterike, informatike dhe telekomunikuese. Sistemi nervor digjital.
Java e dhjetë:	12 Karakteristikat e Ekonomisë së Internetit.
Java e njëmbëdhjetë:	Trendet e reja në Ekominë e Internetit. Modeli i Ekonomisë së Internetit.
Java e dymbëdhjetë:	Virtualizimi. Logjika e transformimit të ekonomisë industriale në Ekonomi të Internetit.
Java e trembëdhjetë:	Ndërmarrja digjitale. Modeli i inovacioneve në biznes B-Web.
Java e katërbëdhjetë:	Apekte teorike lidhur me biznesin elektronik, format dhe modelet e biznesit elektronik: tregtia elektronike, marketing elektronik, e-bankig, e-government dhe e-learning dhe tregjet elektronike.
Java e pesëmbëdhjetë:	Kollokviumi 2.
